




Në kuadër të zbatimit të projektit Erasmus+ CBHE **SINCERE – Strengthening Integrity and Ethical Culture in Higher Education**, u zhvillua takimi i 16-të online i konsorciumit, me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve të projektit. Takimi u fokusua në shqyrtimin e progresit të paketave të punës, koordinimin e aktiviteteve në vijim dhe respektimin e afateve të përcaktuara në planin e projektit.

Në kuadër të **Paketës së Punës 1 (WP1)** u diskutua ecuria e përgatitjes së raportit të parë të brendshëm gjashtëmujor (M1–M6), duke përfshirë konsolidimin e kontributeve narrative të partnerëve, raportimin financiar, zbatimin e Planit të Sigurimit të Cilësisë, përditësimin e vlerësimit të rrezikut dhe ndryshimet në marrëveshjen e partneritetit.

Vëmendje e veçantë iu kushtua **Paketës së Punës 2 (WP2)**, e cila ka në fokus hartimin e **Kornizës së Integritetit Akademik (Academic Integrity Framework – AIF)**. Gjatë takimit, partneri udhëheqës i kësaj pakete, Akademia **WSB**, prezantoi draftin e Kornizës së Integritetit Akademik përpara anëtarëve të konsorciumit. Prezantimi përfshiu strukturën e dokumentit, objektivat, elementët kryesorë dhe progresin e arritur deri në këtë fazë të projektit.

Pas prezantimit partnerëve, u ftuan të shqyrtojnë draftin dhe të paraqesin komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin e dokumentit. Ky proces konsultimi synon që Korniza e Integritetit Akademik të reflektojë përvojat, nevojat dhe praktikën më të mira të të gjitha institucioneve partnere, përpara miratimit të saj përfundimtar nga konsorciumi dhe dorëzimit të deliverable-it **D2.2**. Gjithashtu, u koordinuan hapat për organizimin e punëtorive të validimit me palët e interesuara në secilin institucion partner, të cilat do të kontribuojnë në finalizimin dhe zbatimin efektiv të Kornizës së Integritetit Akademik.

Në vijim të takimit, në kuadër të **WP3**, partnerët diskutuan progresin e procedurave të prokurimit për softuerin e zbulimit të plagjiaturës, zhvillimin e panelit për monitorimin e përdorimit të inteligjencës artificiale, si dhe ecurinë e planit të prokurimit të pajisjeve për institucionet përfituese.

Në **WP4** u shqyrtua statusi i aktiviteteve të brendshme të shpërndarjes, përditësimi i faqes zyrtare të projektit, aktivitetet promovuese në rrjetet sociale dhe përgatitja e buletinit të parë elektronik vjetor. Gjithashtu, partnerët diskutuan hapat e mëtejshëm për zgjerimin e Rrjetit Rajonal të Integritetit Akademik (RAIN), planifikimin e takimit të ardhshëm të sigurimit të cilësisë dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e suksesshëm të projektit.

Takimi konfirmoi angazhimin e të gjithë partnerëve për të përmbushur objektivat dhe afatet e projektit, duke forcuar më tej bashkëpunimin ndër-institucional në zhvillimin e politikave dhe mekanizmave për promovimin e integritetit akademik dhe kulturës etike në institucionet e arsimit të lartë.